



REPUBLIKA KOSOVË

VJUQISHËM  
OSNAZNA  
SUD / ASLİYE MAHKEMESİ  
PRIZREN - PRİZRENE

P.nr. 362/2015

30.01.2018

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me sekretaren juridike Mire Beqiraj, punëtore e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit: I. M. nga [REDACTED] dhe B. K. nga [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje nga nenin 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KP-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 586/2014, të dt. 26.02.2015 pas mbajtjes së shqyrimit fillestar në pranin e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm Zejnullah Gashi, të akuzuarit I. M. dhe B. K., me dt. 29.08.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:**

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

I. M. – nga i ati A. [REDACTED], dhe e ëma Sh. [REDACTED] mbiemri i vajzërie B. [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED] në [REDACTED], ku dhe tani jeton, në rrugën ‘[REDACTED]’ [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës.

B. K. – nga i ati I. [REDACTED], dhe e ëma t. [REDACTED] mbiemri i vajzërie A. [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED] në [REDACTED], ku dhe tani jeton, në rrugën ‘[REDACTED]’ nr. [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës.

### JANË FAJTOR

Se me dt. 14.01.2014, rrathi orës 18:00 minuta, në Prizren rruga “[REDACTED]” saktësishtë në marketin “[REDACTED]” në bashkëveprim ia marrin të dëmtuarit pasurinë me qëllim të përvetimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, në atë mënyrë që të pandehurit në bashkëveprim në mënyrë të vazhdueshme në tre lokacionet e marketeve kishin vjedhur alkool të llojit: 5 ximbina, 6 civas, 9 xhek danijells, 6 jegar maisters, 6 xhoni workers, lidhur me këtë i dëmtuar kishte vërejtur se në marketet e tij mungojnë sasi e konsiderueshme e alkoolit dhe pastaj kishte vendosur kamera të cilat tregojnë çart për aktin e vjedhjes në bashkëveprim të pandehurve I. M. dhe B. K.

Kësot dore kanë kryer veprën penale të vjedhjes nga nenin 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,8,9,10,21,27,41,43,45.nenit 378.par.9.lidhur me par.6.të KP-së dhe nenin 365.të KPP-së të akuzuarin e:

██████████ ██████████ ██████████ ██████████ █

██████████ ██████████ ██████████

██████████ ██████████ ██████████ ██████████ █

██████████ ██████████ ██████████ ██████████ █

██████████

██████████ ██████████ ██████████ █

## GJ Y K O N

Të akuzuarin I. M. për veprën penale vjedhje nga neni 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KP-së me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) € të cilin dënim është i obliguar të paguaj në afratin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarin B. K. për veprën penale vjedhje nga neni 325.par. 1.lidhur me nenin 31.të KP-së me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) € të cilin dënim është i obliguar të paguaj në afatin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari F. R. H. nga rr. " " për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

**OBLIGOHEN** të akuzuarit që të i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej 20 € e të gjitha këto. në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykata ka parashtruar Aktakuzën PP/II.nr. 586/2014 të dt. 26.02.2015 kundër të akuzuarve: I. M. nga " " dhe B. K. nga " ", për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KP-së. Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me dt. 14.01.2014, rreth orës 18:00 minuta, në Prizren rruga " " saktësisht në marketin " " në bashkëveprim ia marrin të dëmtuarit pasurinë me qëllim të përvetimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjeter, në atë mënyrë që të pandehurit në bashkëveprim në mënyrë të vazhdueshme në tre lokacionet e marketeve kishin vjedhur alkool të llojit: 5 ximbina, 6 civas, 9 xhek danjells, 6 jegar maisters, 6 xhoni workers, lidhur me këtë i dëmtuari kishte vërejtur se në marketet e tij mungojnë sasi e konsiderueshme e alkoolit dhe pastaj kishte vendosur kamera të cilat tregojnë çart për aktin e vjedhjes në bashkëveprim të pandehurve I. M. dhe B. K.

Gjykata këto fakte i ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë. Gjykata sipas detyrës zyrtare konformë nenit 257.të KPP-së, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të papranueshme, po ashtu gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kupuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pranimi i fajit nga ana e të akuzuarve është bërë vullnetarisht dhe pa presion, dhe shprehin pëndim të thellë



duke shtuar se premtojnë se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra tjera që janë në kundërshtim me Ligjin, ky pranim mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu gjykata në tërësi ka ardhur në konkludim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar publik nga ana e të akuzuarve në tërësi është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248., ngase nuk ekzistojnë ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale, dhe këto fakte të qështjes që përmban aktakuza gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha tiparet dhe elementet e veprës penale të vjedhjes nga neni 325.par.1.lidhur me nenin 31.të KP-së, dhe gjykata ka vendosur që të akuzuarit të i shpalli fajtor dhe të i gjykoj në bazë të Ligjit, e më parë duke vërtetuar në tërësi përgjegjësin penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrëthanat në kuptim të dispozitës së nenit 73.të KPP-së, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, në veprimet e të akuzuarve kanë pasur sjellje korekte para gjykatës, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, e kjo nënkuption edhe pendimin e tyre për kryerjen e veprës penale e cila është objekt i akuzës, dhe për këtë gjykata i a shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatjej prej 3 (tre) muajve me bindje se ky dënim i tillë i shqiptuar ta akuzuarve do të ju ndikoj pozitivisht, dhe se të njëjtit i përgjigjen intenzitetit dhe shkallës së përgjegjësisë penale juridike, dhe se ky dënim i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe në rrëthanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil, e bazoi në kuptim të nenit 463.par.1. e 2. të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet dhe pashallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453.par.1. të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij Aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 362/2015 të dt. 29.08.2017

Sekretare juridike,  
Mire Beqiraj

Gjyqtari,  
Gani Kastrati

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi palë e pa kënaqur ka të drejtë Ankesë  
në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.